

TË KUPTOJMË PROGRAMIN COBRA

(Ligji për rakordimin e Buxhetit të shërbimeve të konsoliduara
(Consolidated Omnibus Budget Reconciliation Act))



Nëse humbni sigurimin shëndetësor në punë, ju mund të keni shumë opsione për sigurimin shëndetësor. COBRA është një ndër to. COBRA ju lejon të ruani të njëjtin sigurim shëndetësor që kishit në punë, për një periudhë shtesë kohore.

COBRA zbatohet për punëdhënësit privatë me 20 ose më shumë punonjës, ose për qeveri shtetërore apo federale. COBRA i lejon punonjësit dhe anëtarët e familjeve të tyre të zgjedhin të vazhdojnë sigurimin shëndetësor të sponsorizuar nga punëdhënësi i tyre, pasi të kalojnë një "proces kualifikimi". Shembuj të kësaj mund të përfshijnë: ndërprerjen e punësimit të punonjësit të siguruar ose uljen e orëve të punës; vdekjen e punonjësit të siguruar; të drejtën e punonjësit të siguruar për të qenë pjesë e "Medicare"; shkurorëzimin ose ndarjen me ligj nga punonjësi i siguruar; ose një fëmijë nën kujdestari, në pritje që të bëhet i pavarur sipas kërkesave të përgjithshme të zbatueshme të planit.

Avantazhet:

Mbulimi: ju dhe familja juaj mund t'i mbani ofruesit tuaj për 18 deri në 36 muaj

Koha: keni kohë deri në 60 ditë pas largimit nga puna për të zgjedhur mbulimin COBRA, i cili ju jep kohë të shikoni planet e reja dhe të zgjidhni një prej tyre teksa jeni ende të siguruar

Medikamentet: kostot e barnave ose bashkëpagesat do të mbeten të njëjta

Zgjedhja: shumë shtete kanë ligje për mini-COBRA, të cilat lejojnë përfitime shtesë me mbulimin tuaj

Si të regjistrohni për mbulimin COBRA

- Brenda 45 ditëve nga shpallja si i kualifikueshëm, punëdhënësi duhet t'ju dërgojë një formular zgjedhjeje të COBRA
- Shihni me kujdes njoftimin e zgjedhjes, i cili do të përfshijë opsionet dhe çmimet e planit
- Planet dhe mbulimi duhet të jenë identikë me mbulimin e ofruar për punonjësit e tjerë
- Nëse zgjidhni të regjistrohni, plotësoni formularin dhe dorëzoni atë brenda 60 ditëve

Përfitimet nga COBRA janë një zgjidhje e përkohshme. Mund të konsideroni të kërkonte një sigurim afatgjatë, ose të krahasoni dhe të blini mbulim me sigurim nga tregu i Aktit të Kujdesit të Përbalueshëm (Affordable Care Act).

Disavantazhet:

Kostoja: ju duhet të paguani të gjithë primin tuaj të vjetër, duke përfshirë pjesën që punëdhënësi juaj ka mbuluar më parë, plus tarifatat administrative

Skadencia: planet e COBRA përfundojnë pas një periudhe specifike dhe ju duhet t'u kushtoni vëmendje afateve

Mungesa e fleksibilitetit: nëse paguani me vonesë ndonjë tarifë të COBRA, mbulimi juaj do të përfundojë

Cilat janë afatet e COBRA që duhet të di?

- Periudha 60 ditore për zgjedhjen e mbulimit COBRA. Këto 60 ditë fillojnë në datën kur jeni shpallur të kualifikueshëm, ose në datën kur merrni një njoftim nga punëdhënësi juaj, cilado të jetë më e vonshme.
- Periudha 45 ditore për të bërë pagesën tuaj të parë primit COBRA dhe periudha 30 ditore për të bërë çdo pagesë shtesë të primit COBRA;
- Periudha 60 ditore, kur punonjësit duhet të japin njoftim mbi planin e shpalljes të kualifikueshëm për COBRA, ose një përcaktim të aftësisë së kufizuar; dhe
- Administratori i planit duhet të njoftojë punonjësin në lidhje me mundësinë për të mbajtur sigurimin e tyre shëndetësor nga COBRA. Zakonisht, ata kanë kohë 44 ditë nga shpallja si të kualifikueshëm.

MOQC

MICHIGAN ONCOLOGY
QUALITY CONSORTIUM

PYETJE?

<https://moqc.org/>

moqc@moqc.org